



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 34, datë 27.02.2025

PËR

**MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT REKREACION DHE PARKIM ZONA L, GREEN COAST RESORT 2”, ME
VENDNDODHJE NË PALASË, BASHKIA HIMARË**


Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues, shoqërisë “Green Coast” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Objekt rekreacion dhe parkim Zona L, Green Coast Resort 2”, me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Green Coast” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin Nr. 122, Prot., 330/1, datë 27.09.2022 të Bashkisë Himarë, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22/09 2025